

PARTIA LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM

HISTORIKU

Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) u krijua më 6 shtator 2004, si një fraksion i Partisë Socialiste e cila gjatë kësaj kohe ndodhej në pushtet. Në zgjedhjet e 3 korrikut 2005, LSI arriti që të fitonte 5 mandate deputetësh për në parlament, ku kryetari i saj Ilir Meta ishte i vetmi përfaqësues nga partitë e vogla që arriti që të zgjidhej deputet në mënyrë maxhoritare. Partitë e tjera të vogla fituan akoma më shumë deputetë me anë të marrëveshjeve për pjesën proporcionale që bënë me dy partitë e mëdha PD dhe PS. Në vitin 2008 dy partitë politike kryesore PD dhe PS arritën një marrëveshje politike midis tyre për ndryshimin e kushtetutës në disa elementë thelbësor të saj, ndërmjet të tjerash dhe të sistemit zgjedhor duke kaluar nga sistemi miks i votimit në sistemin proporcional rajonal, i cili dukej se kërkonte të shmangte forcimin e partive të vogla të tilla si LSI. Kryetari i LSI Ilir Meta i kundërshtoi me forcë me këto ndryshime kushtetuese, por procesi u mbyll me votimin konsensual në parlament midis deputetëve të dy partive kryesore politike në prill të vitit 2008. Në zgjedhjet e përgjithshme elektorale të 28 qershorit 2009, LSI arriti që të fitonte 4 deputetë dhe të renditej forcë e tretë politike në vend. Duke qenë se koalicionit fitues të udhëhequr nga Partia Demokratike iu mungonte numri i duhur i deputetëve për krijimin e qeverisë së re, LSI u bë pjesë e kabinetit të ri qeveritar me dy ministri: Ministrinë e Jashtme dhe Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Kryetari i LSI Ilir Meta i cili ishte Ministër i Jashtëm ishte gjithashtu dhe zëvendëskryeministër i qeverisë Berisha 2. Gjatë kohës së qëndrimit të saj në pushtet, LSI do të arrinte që të zgjeronte anëtarësinë si dhe të krijonte zonat e saj të influencës. Sidoqoftë në prill të vitit 2013, dy muaj përpara zgjedhjeve të përgjithshme elektorale të 23 qershorit 2013, LSI do të krijonte një koalicion parazgjedhor me partinë tjetër të majtë, Partinë Socialiste, e cila gjatë kësaj kohe ishte në opozitë. Zgjedhjet do të fitoheshin nga koalicioni i udhëhequr nga Partia Socialiste. LSI do të vazhdonte që të ri-konfirmohej si forcë e tretë politike me 16 deputetë, si dhe do të ishte pjesë e kabinetit të ri qeverisës Rama me katër ministra. Kryetar LSI-së që nga themelimi ishte Ilir Meta por me zgjedhjen e këtij të fundit si Presidenti i Shqipërisë në krye të partisë në prill 2017 u zgjodh Petrit Vasili. Pas rezultateve të zgjedhjeve të 25 qershorit 2017, pas dorëheqjes së kryetarit Petrit Vasili, i cili propozoi ndryshim të kryesisë së partisë, duke propozuar si kryetare Monika Kryemadhi, nenkryetarë Luan Rama dhe Erisa Xhixho dhe sekretar të përgjithshëm Endrit Brahimllari. Me votim të hapur, ku morën pjesë 2300 delegatë, propozimi i Petrit Vasili u pranua duke shpallur kryetaren e parë femër të një partie politike në Shqipëri.

KRYETARI - MONIKA KRYEMADHI

JETËSHKRIMI

Monika Kryemadhi e ka nisur angazhimin e saj politik që në vitin 1991, ku ajo sëbashku me bashkëshortin e saj Ilir Meta, ishin bashkëthemelues të Forumit Rinor Eurosocialist të Shqipërisë (FRESSH). Në janar të vitit 1992 u zgjodh anëtare e Kryesisë dhe në maj të po atij viti, ajo u zgjodh Sekretare e Përgjithshme e FRESSH-it ne Kongresin e I dhe II. Ajo mbajti funksionin Presidente e FRESSH deri në prill të vitit 2002. Nga viti 1995 deri 2000 ajo u zgjodh nënkryetare e Socialist International Youth (IUSY). Monika Kryemadhi ishte anëtare e Partisë Socialiste nga dhjetori 1991 deri në shtator të vitit 2004. Gjatë kësaj kohe ajo ishte gjithashtu deputete e Kuvendit të Shqipërisë nga viti 2001 deri 2005, si edhe u zgjodh dy herë për Këshillin Bashkiak të Tiranës për të cilin ajo është zgjedhur Sekretare e Delegacionit të Qeverisë Lokale në Këshillin e Evropës. Në shtator të vitit 2004, ajo ishte një nga themeluesit e Partisë Socialiste për Integrim (LSI). Gjatë periudhës 2005-2013 ka mbajtur pozicionin e Sekretares Organizative në Lëvizjen Socialiste për Integrim. Më 5 korrik 2017, Kryemadhi u zgjodh kryetarja e re e Lëvizjes Socialiste për Integrim, duke zëvendësuar Petrit Vasilin, i cili dha dorëheqjen. Monika Kryemadhi është diplomuar për “Bio-Kimi” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës dhe zotëron specializime të ndryshme ndërkombëtare. Që nga viti 2019, ajo ka nisur një fushatë të ashpër për rrëzimin e qeverisë Rama si dhe ka qenë pjesë e marrëveshjes me Partinë Demokratike për djegien e mandatëve të deputetëve.

SEKRETARIATI

<u>Emër Mbiemër</u>	<u>Funksioni</u>
<i>Erisa Xhixho</i>	Sekretare për Marrëdhëniet me Publikun
<i>Edmond Haxhinasto</i>	Sekretar për Çështjet Programore
<i>Eriona Bixha</i>	Sekretare Organizative

KRYESIA

<u>Emër Mbiemër</u>	<u>Funksioni</u>
<i>Adela Karapici</i>	Anëtare e Kryesisë
<i>Edmond Haxhinasto</i>	Anëtar i Kryesisë
<i>Edmond Panariti</i>	Anëtar i Kryesisë
<i>Elona Guri</i>	Anëtare e Kryesisë
<i>Endrit Brahimllari</i>	Anëtar i Kryesisë
<i>Eriona Bixha</i>	Anëtare e Kryesisë
<i>Eris Zaimi</i>	Anëtare e Kryesisë
<i>Erisa Xhixho</i>	Anëtare e Kryesisë
<i>Flolda Kërpaci</i>	Anëtare e Kryesisë
<i>Kejdi Mehmetaj</i>	Anëtare e Kryesisë
<i>Klajda Gjoshaj</i>	Anëtare e Kryesisë
<i>Klevi Pojana</i>	Anëtar i Kryesisë
<i>Luan Rama</i>	Anëtar i Kryesisë
<i>Luigj Turmalaj</i>	Anëtar i Kryesisë
<i>Monika Kryemadhi</i>	Anëtare e Kryesisë
<i>Nasip Naço</i>	Anëtar i Kryesisë
<i>Nora Malaj</i>	Anëtare e Kryesisë
<i>Përparim Spahiu</i>	Anëtar i Kryesisë
<i>Petrit Vasili</i>	Anëtar i Kryesisë
<i>Rea Kotani</i>	Anëtare e Kryesisë
<i>Shezai Rrokaj</i>	Anëtar i Kryesisë
<i>Silva Caka</i>	Anëtare e Kryesisë
<i>Sokol Dervishaj</i>	Anëtar i Kryesisë
<i>Vangjel Tavo</i>	Anëtar i Kryesisë
<i>Ylli Manjani</i>	Anëtar i Kryesisë

DEPUTETËT (2017-2019)

<u>Emër Mbiemër</u>	<u>Funksioni</u>
<i>Nasip Naço</i>	Deputet
<i>Gledjon Rehovica</i>	Deputet
<i>Përparim Spahiu</i>	Deputet
<i>Lefter Koka</i>	Deputet
<i>Nora Malaj</i>	Deputete
<i>Monika Kryemadhi</i>	Deputete
<i>Edmond Haxhinasto</i>	Deputet
<i>Petrit Vasili</i>	Deputet
<i>Robert Bitri</i>	Deputet
<i>Vangjel Tavo</i>	Deputet
<i>Edmond Panariti</i>	Deputet
<i>Viktor Tushaj</i>	Deputet
<i>Agron Çela</i>	Deputet
<i>Klajda Gjoshaj</i>	Deputete
<i>Kejdi Mehmetaj</i>	Deputete
<i>Floida Kërpaçi</i>	Deputete
<i>Endrit Braimllari</i>	Deputet
<i>Luan Rama</i>	Deputet
<i>Sezai Rokaj</i>	Deputet

KOMITETIT DREJTUES KOMBËTAR (KPK)

Më datë 21 nëntor 2020 janë zhvilluar zgjedhjet në LSI për strukturat e reja drejtuese për të cilët kanë votuar delegatët e Konventës Kombëtare.

ZYRTARËT PËRFAQËSUES

Për shkak të vendimit politik në koalicion me Partinë Demokratike për djegien e mandateve të deputetëve, LSI nuk ka përfaqësues në Kuvend. Gjithashtu ajo nuk mori pjesë në zgjedhjet vendore të vitit 2019.